



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
- Njoftim për mediumet -

Shkup, 04.08.2022

Ngecje, dinamik e ngadalësuar dhe rritje të shpenzimeve për projektet infrastrukturore

Ekziston ngecje dhe dinamik e ngadalësuar e realizimit të projekteve strategjike infrastrukturore, ndërsa shpenzimet për projektet janë rritur për shkak të çmimeve të larta të vlerës së ndërtimit nga planifikimi fillestar, si dhe për shkak të shpenzimeve dytësore

Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizionin e suksesit me temën **"Huamarrja e subjekteve të sektorit publik, shkalla e shfrytëzimit të kredive dhe huave dhe shpenzimet e paguara dhe të krijuara"** me qëllim që t'i përgjigjet pyetjes:

Investimet publike që financohen me fondet e kredisë a realizohen në mënyrë efikase dhe ekonomike?

Me revizionin e kryer është konstatuar:

- se në menaxhimin me investimet publike **mungon** korniza juridike sistematike, procedura, institucione kompetente dhe indikatorë të përcaktuar për sistem për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të investimeve publike, që kontribuon në ndërmarrjen jo në kohë të masave korigjuese;
- projektet kryesore monitorohen në mënyrë të decentralizuar për të cilat **nuk ekziston** pasqyrë gjithëpërfshirëse për progresin e implementimit;
- rregullativa nga fusha e ndërtimit në tërësi **nuk kontribuon** në Implementimin efikas të projekteve sipas kushteve ndërkombëtare FIDIC për ndërtim;
- kontratat e lidhura për ndërtim sipas kushteve ndërkombëtare FIDIC, **shkaktojnë** shpenzime shtesë dhe rreziqe nga kërkesat shtesë nga kontraktuesi, rreziku i ndërprerjes së kontratave dhe arbitrazhit ndërkombëtar;
- te projektet ka **devijime** të ndërtimit nga projekti bazë dhe njihen punime shtesë dhe të paparashikuara gjatë ndërtimit (variacione);
- me shpronësim të pazgjedhur janë lëshuar aprovime për ndërtime për projekte infrastrukturore lineare të rregulluara me Ligjin për ndërtime. Procedura

komplekse për përcaktimin e kompensimit për shpronësim, si dhe procedura e miratimit të projekteve infrastrukturore ndikojnë në shkallën e realizimit - **dinamikë e ngadaltë dhe ngecje të projekteve.**

Me revizionin janë përfshi projektet për të cilat janë krijuar shpenzime në vlerë prej **58 milionë euro**, të cilat i referohen provizionit të njehershëm, interes për mjetet e tërhequra dhe provizion për mjetet e patërhequra.

11 projekte të reviduara	HUAMARRJE	MIETE TË TERHEQURA	SHPENZIME
Ndërtimi i segmentit të autostradës Kërçovë-Ohër	505.044.966\$	382.598.046	38.634.019\$
Programi për rrugët nacionale	181.000.000€	90.774.210€	7.091.325€
Kërçovë Ohër, financime plotësuese	179.694.573\$	/	/
Ndërtimi i ri dhe rikonstiumi i segmentit ekzistues Bellakovcë – Kriva Pallankë	145.000.000€	1.450.000€	6.384.940€
Zhvillimi dhe mbindërtimi Rankovcë – Kriva Pallankë	73.000.000€	32.347.299€	1.655.085€
Ndërtimi i rrugës ekspres Shtip – Radovish	64.000.000€	64.000.000€	2.890.219€
Furnizimi me ujë dhe tharja e ujërave të zeza në komunat e RMV-së	50.000.000€	40.140.000€	3.038.865€
Rehabilitimi i segmentit të parë të vijës hekurudhore Kumanovë – Bellakovcë	46.400.000€	31.900.955€	2.766.377€
Ndërtimi dhe modernizimi i Qendrës Klinike Rajonale – Shtip	26.937.458€	13.500.000€	320.098€
Remonti i vijës hekurudhore të Korridorit 10	17.600.000€	16.318.013€	1.308.761€
Segmenti rrugor Kriva Pallankë – Deve Balr	10.000.000€	5.100.000€	255.129€

GJITHËSEJ SHPENZIME: 57.998.830€

Revizorët konstatuan se subjektet të cilët janë përgjegjës për realizimin e projekteve, dokumentacioni i projektit **nuk është rezultat** i analizave sistematike, teknike, ekonomike dhe financiare.

Respektivisht, janë lidhur marrëveshje për ndërtime në vlerë prej **12.856.639 mijë denarë**, vlefshmëria e të cilave **është rritur në 15.354.883 mijë denarë** për shkak të pranimit të punëve plotësuese dhe të paparashikueshme.

Me analizat e të hyrave të **NP për rrugët shtetërore** konstatuam se të hyrat janë më pak nga vlera e investimeve të përgjithshme në nivel vjetor, përveç se për vitet 2020 dhe 2021, që shkakton pasiguri në realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore.

Revizorët konstatuan se shumica e projekteve të cilat realizohen nga **NP për rrugë shtetërore** kanë filluar **në periudhën 2014-2016.**

Ato kanë dinamikë të ngadaltë të realizimit për shkak të dobësive në zgjidhjet teknike si pjesë e dokumentacionit të projektit, ndërprerjes së kontratave me kontraktuesit për arsye të ndryshme, fillimit të procedurave të arbitrazhit ndërkombëtar, pengesave administrative për fillimin e shpronësimit, kornizës komplekse juridike me më shumë institucione të përfshira për përcaktimin e kompensimit për shpronësim e cila e bllokoi zgjidhjen efektive të shpronësimit.

Projekti i Autostradës Kërçovë Ohër



Gjithashtu, me revizionin u konstatua se puna financiare e NP HRMV-së **Infrastruktura** me humbje dhe mungesë të burimeve financiare në periudhë më të gjatë, ndikon negativisht në realizimin në kohë të projekteve strategjike dhe servisimin e borxhit sipas marrëveshjeve për hua.

Projektet e NP HRMV Infrastruktura kanë filluar në **periudhën 2012-2014**, të njëjtit janë në ngecje, nuk kanë përfunduar, **ndërsa prej 2018-2019** shkalla e realizimit në përqindje është **vetëm 1% në nivel mujorë dhe në 2019-2020** marrëveshjet për Korridorin X dhe VIII janë ndërprerë.

Në periudhën e kryerjes së revizionit në vazhdim e sipër ishte vlerësimi për zgjedhjen e kontraktuesve të ri për Korridorin X dhe VIII.

Ndërtimi i Korridorit VIII – faza 1




Ndërtimi i Korridorit VIII – faza 2



Për shkak të dinamikës së ngadaltë të realizimit të projektit, ndryshimeve në dokumentacionin e projektit, anulimit të kreditorit nga marrëveshja për hua dhe financimit të mëtutjeshme të projektit, **ka pasiguri për përfundimin e projektit për ndërtimin e Qendrës së Klinikës Rajonale Shtip.**

Kjo gjendje i komplikon procedurat e mëtutjeshme për vazhdimin dhe realizimin e projektit nga Qeveria e RMV-së dhe institucionet kompetente, me rrezik nga rritja e çmimit të projektit, shpenzimeve shtesë dhe menaxhimit efikas me projektet.



Me qëllim tejkalimin e gjendjeve, efekteve dhe rezultateve të theksuara, në raportin e revizionit janë dhënë rekomandime në funksion të përmirësimit dhe avancimit të procesit të përgjithshëm të menaxhimit me investimet publike.

Kontaktet për shtyp:

Albiona Mustafa Muhaxhiri +389 72228 203 albiona.mustafa@dzr.gov.mk

Mijallçe Durgutov +389 70 358 486 mijalce.durgutov@dzr.gov.mk

Martin Duvnjak +389 75 268 517 martin.duvnjak@dzr.gov.mk